



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 3 Mars 2023

Nr: 92

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS TË BASHKISË SARANDË, PËR
RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 3 Mars 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrative me:

SUBJEKT: Zj. Entela Çipa, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Sarandë

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Sarandë, për raportimin e veprimtarive publike

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 28.1.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin e 1 (një) veprimtarie publike nga ana e bashkisë Sarandë.

Indicia është marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

Data: 3 Mars 2023

Nr: 92
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Sarandë, për raportimin e veprimtarive publike”

“Sot në Ditën Ndërkombëtare të Edukimit me fëmijët e Qendrës së Zhvillimit, ata të qendrës për Zhvillimin e Fëmijës dhe Forcimin e Familjes, nxënës të shkollave, mësues dhe qytetarë dhuruan libra në shtëpizat e librit në Sarandë e Ksamil, si dhe ndoqëm aktivitetet e organizuara nga QKF dhe shkollat e qytetit në bibliotekën e Sarandës”.

Link: <https://bashkiasarande.gov.al/2023/01/24/aktivitete-gjitheperfshirese-ne-diten-boterore-te-edukimit/>

Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator dhe është trasmetuar në 2 (dy) media publike.”

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, pasi u shqyrtua paraprakisht çështja, u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Më datë 16.2.2023, bashkisë Sarandë i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 20.2.2023, bashkia Sarandë bën me dije se: *“Aktiviteti është zhvilluar më datë 24.1.2023 ora 11.00 në Bibliotekën e qytetit nga Zyra Arsimore Sarandë në bashkëpunim me Qendrën Kulturore me temë “Të edukojmë përmes fabulës” në ditën botërore të edukimit. Pjesëmarrës në aktivitet ishin mësues, nxënës si dhe përfaqësues të bashkisë...”*

Pasi informacionit të marrë, më datë 2.3.2023, i jemi drejtuar me kërkesë për informacion Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Sarandë, nëpërmjet adresës elektronike, mbi indicien e marrë dhe deklaratimet e bëra nga ana e bashkisë Sarandë.

Më datë 3.3.2023 Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Sarandë-Konispoll-Delvinë, bën me dije se: *“Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Sarandë-Konispoll-Delvinë ka mbështetur aktivitetin e datës 24 Janar 2023 e shënjuar si Dita Botërore e Edukimit, organizuar nga bashkia Sarandë. Bashkëlidhur po ju dërgojmë të skanuar edhe komunikimin me ehatsapp të datës 16.1.2023 me z. Thoma Nika ...”.*

Në vijim të hetimit administrativ bashkia Sarandë, me shkresën nr. 1143 prot. datë 2.3.2023, informon se: *“... Lidhur me mosraportimin në kohë të kësaj veprimtarie me impakt komunitar, ju sqarojmë se arsyet janë të lidhura vetëm me mosmarrjen ende, deri në atë datë, të kredencialeve të komunikimit tonë me KQZ në ndërfaqen e bashkisë sonë, bashkia e Sarandës, prej disa kohësh, e ka vakant vendin e Sekretarit të Përgjithshëm, i cili do të duhej të ishte*

personi i ngarkuar nga ligji për te kryer komunikimin me ju për aktivitetet që realizohen prej 13.01.2023 deri më 14.05.2023...”

Pas verifikimit të rrethanave dhe fakteve, vlerësohet se problematikat me sistemin dhe kredencialet kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive jashtë vullnetit të organit publik.

Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrativ për ato shkelje që lidhen me çështjen objekt shqyrtimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Sarandë, nuk përbën shkelje të nenit 92, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj zj. Entela Çipa, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në bashkinë Sarandë.
2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Tërheqje vëmendje ndaj bashkisë Sarandë, për marrjen e masave të menjëhershme, për raportimin e veprimtarive publike.
4. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 3 Mars 2023

Nr: 92
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Sarandë, për raportimin e veprimtarive publike”